



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 5351

Tirane, date 31/04/2015

Drejtuar: Z. JANI GUXO
SHOQERIA "JANIMAR" SH.P.K
FSHATI DERVICIAN

GJIROKASTER

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.966 date 05.09.2006.

I nderuar zoti Guxo,

Shoqëria "Janimar" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.966 date 05.09.2006, për gëlqeror pllakore, ne objektin "Jergucat", Dropull i Poshtëm, ne Qarkun Gjirokastër.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 5169 date 12.05.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.3872 date 13.05.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.966 date 05.09.2006, për gëlqeror pllakore, ne objektin "Jergucat", Dropull i Poshtëm, ne Qarkun Gjirokastër, për arsye se është ndërprere puna për me shume se një vit pa njoftuar me pare strukturat përgjegjëse siç është përcaktuar ne ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në gjuhën "c" të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sa me sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.966 datë 05.09.2006, për gëlqeror pllakore, në objektin "Jergucat", Dropull i Poshtëm, në Qarkun Gjirokastrë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.966 datë 05.09.2006.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minierar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

